



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Kontratës Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Impiantit të Ujërave të Zeza në Gjilan.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Likuiditet të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e një euro (111,801.00) për Zyrën Kombëtare të Auditimit, për zbatimin e projektit "Softueri për menaxhimin e proceseve të auditimit (SMPA).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen në organizatën buxhetore Zyra Kombëtare e Auditimit me kod 302, në nën programin "Departamenti i Auditorëve" me kod 13400, në kategorinë e shpenzimeve kapitale për projektin "Softueri për mbështetje të auditimit" me kod 18273 .
3. Obligohet Ministria e Financave, Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Grupit Punues Ndërinstitucional për avancimin e rrugës integruese të Republikës së Kosovës drejt Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior NATO

1. Themelohet Grupi Punues ndër institucional për koordinim dhe mbështetje për avancimin e Republikës së Kosovës në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior - NATO.
2. Grupi punues nga pika 1. e këtij vendimi ka për synim realizimin e objektivit të Republikës së Kosovës për integrim në NATO, si dhe rritjen e bashkëpunimit me aleatët strategjik ndërkombëtar, të cilët janë pjesë e kësaj organizate.
3. Grupi Punues nga pika 1. e këtij vendimi themelohet në këtë përbërje:
 - 3.1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Kryesuese;
 - 3.2. Ministri i Mbrojtjes - anëtar;
 - 3.3. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës - anëtar;
 - 3.4. Përfaqësues i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës - anëtar/e;
 - 3.5. Përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit - anëtar/e;
 - 3.6. Përfaqësuesi diplomatik i Republikës së Kosovës për NATO (Bruksel).
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues të krijuar, sipas pikës 1. të këtij vendimi, përfshijnë por nuk kufizohen në fushëveprimin si në vijim:
 - 4.1. Koordinimin e veprimeve konkrete, me qëllim të avancimit të Republikës së Kosovës në NATO;
 - 4.2. Intensifikimin e punës për procesin e integritit në NATO, duke avancuar praninë e Kosovës në mekanizma rajonale të sigurisë si mekanizma komplementar dhe përkrahës të synimit për anëtarësimin në NATO si dhe të dëshmoj se transformimi i FSK-së, si çështje të brendshme është e bazuar në një proces institucional dhe ligjor.
 - 4.3. Ndërmarrjen e veprimeve të tjera institucionale, që kanë për synim avancimin e rolit të Republikës së Kosovës, në raport me NATO-n.
5. Takimet e grupit punues kryesohen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
6. Përbërja e grupit punues mund të zgjerohet, varësisht nga vlerësimi i nevojave për përfshirjen e institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës.

7. Aktiviteti dhe puna e grupit punues financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.
8. Me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit, aktiviteti, puna dhe dokumentacioni i grupit punues, është i kufizuar.
9. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, obligohet që të krijojë të gjitha kushtet teknike dhe logjistike, për mbarëvajtjen e punëve të Grupit punues për avancimin e rrugës integruese të Republikës së Kosovës në NATO.
10. Obligohen të gjitha Institucionet relevante për zbatimin e këtij vendimi.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HODI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 dhe 8 të Ligjit Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, afirmon angazhimin e saj për të promovuar dhe forcuar kujtesën ndaj Holokaustit dhe për të luftuar Antisemitizmin në të gjitha format e tij.
2. Duke besuar se antisemitizmi përbën një kërcënim serioz dhe një sulm kundër demokracisë, vlerave universale të të drejtave të njeriut dhe kohezionit shoqëror.
3. Të bindur se duhet të vendoset një ekuilibër midis ruajtjes së parimit të lirisë së shprehjes dhe parimit të respektimit të dinjitetit njerëzor.
4. Për qëllime të larcekura dhe duke ju referuar Dokumentit të Aleancës Ndërkombëtare për Rikujtimin e Holokaustit, me anë të së cilit është miratuar përkufizimi ndaj Antisemitizmit.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës, kërkon nga Autoritetet Përgjegjëse që të ndër marrin hapat e nevojshëm proceduralo-ligjor për njohjen e shprehjeve dhe sjelljeve antisemitike.
6. Obligohen organet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për zbatim të këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete shtesë financiare në vlerë prej dyqind e tridhjetë mijë euro (230,000.00 €) sipas kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, për sigurimin e procesit të deratizimit, dezinfektimit dhe dezinfektimit (DDD) të ndërtesave qeveritare që menaxhohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen në organizatën buxhetore Ministria e Punëve të Brendshme, me kod 214, në nën programin "Departamenti i Standardeve dhe Politikave", me kod 12300, te kategoria ekonomike "Mallra dhe Shërbime".
3. Obligohet Ministria e Financave, Thesari i Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/30

Datë: 14.09.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit - Themelimi i Qendrës Përkujtimore për Gjenocidin mbi Shqiptarët "Bllaca 1999" Komuna Hani i Elezit, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave të bashkëngjitur këtij vendimi në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarëve për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit (MEA) në koordinim me Ministrinë e Financave do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HODI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen kriteret për financim të projekteve të komunave për mbështetjen e komunave të Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19.
2. Ministria e Pushtetit Lokal, formon komision vlerësues dhe mjetet shperndahen sipas Raportit të komisionit në komunat përkatëse.
3. Ministria e Pushtetit Lokal, njofton Ministrinë e Financave për kodet dhe programet ekonomike, për secilën komunë me qëllim të alokimit të mjeteve financiare nga ky fond.
4. Obligohet Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave për implementimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Skemën e Ndihmës Sociale.
2. Obligohen Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/30

Datë: 14.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 19, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Rishikuar 2021-2023.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që dokumentin sipas pikës 1. të këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë